



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	09.12.2025	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01	60/01-29878	1.	



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

RAPORT PUNE I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2025

Kaçanik, dhjetor 2025

RAPORT PUNE I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2025

Komiteti për Komunitete është trup i përhershëm punues i Kuvendit të Komunës. Komiteti për Komunitete është formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-38151/2021 me datë: 29.12.2021 në përbërje: 5 anëtarë, dhe atë:

- | | | |
|--------------------------|----------------------|---------|
| 1. Lejla Muhaxheri –Çaka | PDK | anëtar |
| 2. Arta Avdiu | LVV | anëtar |
| 3. Betim Shala | LDK | anëtar |
| 4. Ekrem Livoreka | AAK | anëtar |
| 5. Arben Thaqi | OJQ/ Shoqëria civile | anëtar. |

Me Komiteti për Komunitete udhëheq, Ekrem Livoreka, i zgjedhur sipas Vendimit të Komitetit për Komunitete. Ekrem Livoreka nga data 24.04.2025, në KK ka vepruar i pavarur, pasi që ka dhënë dorëheqje nga AAK.

Detyrat e Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, detyrat e Komitetit për Komunitete janë: shqyrtimin e politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për të u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Ky komitet i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të mirren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën për të u avancuar, shprehur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor si dhe për të siguruar mbrojtjen adekuate të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Aktiviteti i Komitetit për Komunitete për gjatë vitit 2025 është zhvilluar në takime të rregullta në bazë të Planit të Punës së Komitetit për Komunitete.

Gjatë periudhës raportuese ky komitet ka mbajtur gjithsej 09 mbledhje të rregullta, ashtu siç janë paraparë në Planin e punës së këtij komiteti, kjo tregon për përmbushje të planit 100%., krahasuar me periudhën e mbajtjes së mbledhjeve, për shkak të zgjedhjeve lokale të 12 tetorit 2025. Mbledhjet e Komitetit për Komunitete kanë qenë të suksesshme dhe konstruktive, prezenca e anëtarëve në mbledhje ka qenë e rregullt, në mbledhje ka mbretëruar një frymë e punës dhe bashkëpunimit në mes të anëtarëve të përfaqësuar në këtë komitet. Për të gjitha mbledhjet e Komitetit për Komunitete është mbajtur procesverbal, i cili është aprovuar në mbledhjen vijuese të Komitetit për Komunitete. Procesverbali i mbledhjes është bërë transparent në faqen zyrtare të komunës dhe është bazë për nxjerrjen e këtij raporti dhe për me ditur sesi ka funksionuar ky komitet. Për të gjitha mbledhjet, vlen të përmendet se 4 anëtarë të Komitetit për Komunitete janë kompensuar sipas Udhëzimit Administrativ për kompensimin e stafit politik në komunë, me përjashtim të anëtarit nga OJQ/ Shoqëria civile, Arben Thaqi, përkundër se është përcjellë raporti i pjesëmarrjes për kompensim nga sektori i KK, arsyetimi i drejtorisë është se nuk është lejuar kompensimi nga MFET me çka i njëjti ka inicuar çështjen e kompensimit në procedurë gjyqësore. Në mbledhje janë ftuar edhe drejtorët e drejtorive përkatëse komunale për tema të caktuara për me dhënë sqarime të nevojshme, të cilët kryesisht iu kanë përgjigjur ftesës vet apo kanë dërguar ndonjë zyrtar nga drejtoria përkatëse.

Lidhur me përgjegjësitë e këtij komuniteti, kemi pasur bashkëpunim me zyrtarët e OSBE, materiali i mbledhjes i është dërguar zyrtarëve të OSBE-së Jeton Lika. Meqenëse komuna e Kaçanikut nuk ka minoritete, komiteti për komunitete është munduar t'i trajtoj disa tema të cilat i prekin interesat e komuniteteve, OJQ dhe grupeve tjera të interesit, por pa pasur mundësi të bëjë ndonjë zgjidhje.

Ndër çështjet e shqyrtuara të Komitetit për Komunitete janë:

1. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025:

Komiteti për Komunitete ka hartuar një Plan Pune ku janë paraparë 10 mbledhje, janë paraqitur objektivat e Komitetit për Komunitete për vitin 2025, i cili plan pune është miratuar nga Kuvendi i Komunës. Komiteti për Komunitete. Gjatë periudhës raportuese ky komitet është munduar t'i përmbush në një formë objektivat e paraqitur si në këtë plan pune, duke trajtuar çështje që janë në interes të qytetarëve, OJQ apo grupeve tjera të interesit, është informuar dhe ka debatuar për çështje të caktuara, por nuk ia ka arritur sa duhet, sepse çdo objektivi e paraqitur si në planin e punës, ka edhe koston financiare, dhe ky komitet nuk është vendimmarrës. Plani i Punës i Komitetit për Komunitete është miratuar nga Kuvendi i Komunës me 31.03.2025. Në vazhdim do t'i paraqesim disa nga objektivat e paraqitura në këtë plan, të cilat i ka shqyrtuar Komiteti për Komunitete:

1.1 Të drejtat e qytetarëve me aftësi të kufizuara në komunën e Kaçanikut

Komiteti për Komunitete ka realizuar një vizitë në institucionet HANDIKOS, për me u ditur për respektimin e të drejtave dhe kushteve të personave me aftësi të kufizuara, funksionimin e kësaj OJQ. Për këtë çështje mori informata të nevojshme nga drejtoresha e HANDIKOS Elmi Hane Malsiu për mënyrën e funksionimit të kësaj OJQ dhe aktivitetet që zhvillojnë. Drejtoresha theksoj se përkundër përkrahjen nga niveli lokal dhe qendror, nuk është e mjaftueshme për funksionimin e kësaj OJQ, është e nevojshme një koordinim më i mirë dhe mbështetje më e madhe institucionale për të pasur ndikim real dhe afatgjatë. Në mbledhjen e diskutuar këtë çështje, u theksua se shoqëria civile luan një rol kyç në promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, por mbetet sfida sigurimi i fondeve të mjaftueshme dhe krijimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm me institucionet publike. U diskutua rëndësia e edukimit të komunitetit për të eliminuar paragjykimet dhe për të krijuar një mjedis më të përfshirës për këta individë.

Komiteti për Komunitet, shprehën interesimin me mbështetur iniciativa konkrete që ndihmojnë në përmirësimin e jetës së personave me nevoja të veçanta. U dakorduan që të punohet në ngritjen e fushatave sensibilizuese, përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e programeve për fuqizimin e tyre ekonomik dhe social. Në përfundim, drejtoresha theksoi se bashkëpunimi i vazhdueshëm midis institucioneve, organizatave dhe shoqërisë civile është i domosdoshëm për të sjellë ndryshimin.

1.2 Gjendja e Arsimit në Komunën e Kaçanikut;

Komiteti për Komunitete shprehi shqetësimin rënies së numrit të nxënësve, ku si rezultat i kësaj, po vjen deri të mbyllja e shkollave, si mbyllja e shkollës në f. Kotlinë për shkak ndërkaq pati pyetje se a ka gjasa të mbyllet edhe ndonjë shkollë tjetër, si rezultat i rënies së numrit të nxënësve? Komiteti për Komunitete ishte i interesuar me ditur për pajisjen e shkollave me tabela digjitale, projektor dhe material tjetër shpenzues, çështjen e drejtimeve në SHMP, si funksionojnë sallat e edukatës fizike dhe çështjen e pastërtisë në shkolla, çështjen e përzgjedhjes së nxënësve me marrë pjesë në projektin e programit tek Mali, sfidat e shkollave?

Për këtë sqarime të nevojshme dha drejtori i DA Zahir Doda, për numrin e nxënësve 5433 dhe stafit mësimor dhe stafit tjetër, 529, sfida mbetet zvogëlimi i numrit të nxënësve, orët e mbuluara të gjuhës gjermane dhe fizikës, nuk ka pasur aplikant në konkurse. Të gjithë arsimtarët i kam në listë të pagave, ndërkaq me qarkorën e re buxhetore, mund të kemi përsëri zvogëlim të stafit në shkolla. Janë në procedurë ndërtimi i dy qerdheve për fëmijë,

njëra në Rekë për 40 fëmijë, besoj se do të filloj sivjet ndërtimi, është ndarë parcela, ekziston projekti detal dhe është dhënë leja e ndërtimit, procedura është në fazën e tenderimit nga ministria. Çerdhja tjetër është në Kaçanik të Vjetër, është ndarë parcela, është kompletuar dokumentacioni i nevojshme, kemi menduar përmes fondit të IPA të bashkimit Evropian, por për shkak të bllokimit të fondeve, kjo çerdhe me gjasë nuk do të filloj sivjet. Shkolla "Emin Duraku" është në kod të ministrisë, është duke u punuar projekti detal, jemi në fazën e lëshimit të lejes së ndërtimit, kemi premtime se sivjet do të filloj ndërtimi i saj. Në shkollat ku ka me shumë nxënës, janë planifikuar salla të edukatës fizike, në Biçec është në përfundim e sipër, pastj vazhdohet në Bob ku janë bërë përgatitjet e nevojshme, pastaj në Dubravë. Drejtori paraqiti si shqetësuese çështjen e sigurisë në shkolla, fëmijë që bartin armë në shkolla. Me i transferua në shkollë tjetër, kemi mundësi, por nuk po ka efekt. Kemi bashkëpunim me policinë e Kosovës, na janë përgjigjur çdo herë kur i kemi thirrur. E keqja e kësaj është se disa prindër nuk kanë kontrollë të fëmijëve të tyre. Përgjigja e drejtorit ishte, me UA të ministrisë që parashohin mbylljen e shkollave, shkolla e Kotlinës kanë pas mbetur me 3 nxënës për klasat nga 1-9, e kemi bërë sisteminimin e atyre nxënësve në Kovaçe, bëhet transporti i tyre dhe është bërë sistemimi i arsimtarëve. Ne gjendje me kritike për mbyllje janë shkollat: Ivajë dhe Vatë. çdo mësimdhënës që ka 15-20 vjet përvojë punë, nuk guxojmë me lënë pa sistemuar. Për çështjen e pajisjes së shkollave me tabela digjitale, projektor dhe material tjetër shpenzues, si funksionojnë sallat e edukatës fizike dhe çështjen e pastërtisë në shkolla, drejtori theksoj se furnizimi është pak problem për shkak të procedurave, pajisjet për kabinetet i kemi dhuratë nga ministria, po mundohem për tabela digjitale, janë 20 mijë euro mjetet buxhetore të planifikuara. Për çështjen e pastërtisë në shkolla, e përmendi shkollën "Emin Duraku" në Dushkajë, pastaj sqaroj edhe çështjen e përzgjedhjes së nxënësve me marrë pjesë në projektin e programit tek Mali, kriter ka qenë rezultati i shkollave dhe numri i nxënësve, ndërkaq për çështjen e drejtimeve në SHMP, që u ngrit si pyetje për drejtime të reja, mjeksi, arqitekturë e ndërtimtari, është problem me stafin për drejtime të reja. Ne mundemi me marrë prej bizneseve floktarë e rrobaqepës, me i paguar si arsimtar, dhe me iu lëshuar nxënësve certifikata.

1.3 Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut;

Komiteti për Komunitete shprehi shqetësimet e veta për gjendjen e sigurisë në komunën e Kaçanikut për rastet që po ndodhin, mosfunksionimin e kamerave, kompetencën për mbikëqyrjen e tyre, bashkëpunimin e policisë me prokurorinë dhe gjykatës, për parandalimin respektivisht zbardhjen e rasteve që ndodhin në komunën e Kaçanikut. Për me folë për këtë temë nga policia e Kosovës ishte z. Jaser Jaha, i cili i përmendi rastet e ndodhura në këtë tremujor, dhe rastin me të rëndë, vrasja e rreshterit, hetimet që janë marrë për rastin në fjalë nga organet kometente dhe që janë në vazhdim. Ai theksoj se jemi duke u angazhuar për plan të veprimit për organizimin e ligjeratave në shkolla, për temat që lidhen me sigurinë në shkolla, plane operative për sigurinë në trafik dhe për sigurinë e përgjithshme. Janë 68 kamera të sigurisë, që nuk janë funksionale. Në vitet 2017-2018, bëhet fjalë për dy projekte të cilat kanë qenë nën menaxhimin e kompanisë fituese të tenderit për 2 vjet. Pas kësaj periudhe kamerat janë dëmtuar si pasojë e reshjeve atmosferike dhe punimeve ndërtimore. Kemi adresuar kërkesa në komunë, na është thënë se nuk kanë buxhet, edhe në nivel të policisë nuk kemi buxhet, ndërkaq të gjitha stacionet e policisë kanë marrëveshje interne për mirëmbajtjen e tyre. Përmes një iniciative i kemi riparuar disa prej tyre, ndërkaq janë dëmtuar përsëri. Sipas një urdhërese të Shtabit të përgjithshëm të policisë së Kosovës, monitorimi i kamerave të sigurisë bëhet nga policia e Kosovës, një pjesë e kamerave kanë qenë të monitoruar nga komuna, nga ajo periudhë është ndërprerë. Nga një zyrtar i komunës jam informuar për planifikimin për riparimin e

kamerave të sigurisë, kemi bërë projekt edhe për shtimin e tyre në hyrje dhe dalje të fshatrave. Bashkëpunimi në me prokurorinë dhe gjykatën është i ndërsjelltë.

1.4 Kushtet e bujqëve në komunën e Kaçanikut;

Komiteti për Komunitete ishte i interesuar për kushtet e bujqëve në komunën e Kaçanikut, përfituesit e subvencioneve nga MBPZH dhe nga komuna, bashkëpunimi i komunës me ndonjë OJQ tjetër, qasja e fermerëve në tregjet lokale dhe rajonale, organizimi i ndonjë panairi bujqësor apo ekspozitë për të promovuar prodhimet vendore të komunës tonë? Sa i plotëson tregu i gjelbër kushtet për ekspozimin e prodhimeve vendore të këtyre bizneseve, iniciativat për t'iu ndihmuar në procesin e aplikimit për subvencione, numrin e popullsisë që merren me bujqësi, trajnimet për pajisjen moderne, subvencionet që do të jepen, monitorimi i punës në terren, ndihmën e nevojshme për fermerët që janë të interesuar në zhvillimin e prodhimit të mbyllur.

Për këto çështje, foli drejtori i DBPZHR, Suhad Dullovi, për buxhetin dhe shpërndarjen për tre vite, koshere për bletë, centrifuga për mjaltë, sera, motokultivatorë, subvencionet edhe nga MBPZHR për hektar për kultura të ndryshme bujqësore: misër, grurë dhe të tjera. Për s vite i mbështetur, 1,100 përfitues në sektorët e blegtorisë, bletarisë, pemtarisë, mekanizimit bujqësor. Kemi bashkëpunim të ngushtë me OJQ edhe ato ndërkombëtare, kemi dorëzuar kërkesa konkrete, drejtoria është shpërblyer me mbështetje të prekshme për fermerët. Kemi pasur kërkesa për dëmet e shkaktuara në pyje, nuk kemi pasur përgjigje nga ministritë. Kemi dërguar një plan konkret në ministri për ndërhyrje dhe mbështetje për dëmet që janë shkaktuar në Parkun Kombëtar "Sharri", nuk kemi përgjigje. Përgjigje nuk kemi as për projektin e ndërtimit të një kanali ujitës me sistem të mbyllur. Në vitet 2023 dhe 2024 nuk kemi pasur përfitues të subvencioneve dhe granteve të ministrisë, ka pasur kërkesa për ndërtimin e stallave dhe për lopë. Kemi pasur takime me Shoqatën QATAR, për disa projekte për serra, mekanizëm bujqësor dhe bletari, takim me organizatën turke TIKa, kemi marrë mbështetje morale dhe premtim për mbështetje nga organizata "Islamic Relief". "The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints", na ka mbështetur me 100 serra gjatë vitit 2024, jemi për një marrëveshjeje të re për këtë vit. Fermerëve u janë mbajtur trajnim për blegtorët dhe për sektorin e bletarisë u është ofruar ndihmë edhe gjatë procesit të aplikimit. Tregut të gjelbër, nuk i plotëson kushtet 100% si një treg evropian, por nuk ka pasur ndonjë ndalesë për fermerët që të dalin dhe të shesin produktet e tyre. Kemi pasur rreth 500 aplikues fermerë që kanë aplikuar në MBPZHR për pagesa direkte. Buxheti për subvencione u tejkalua mbi 100% - në 300% të realizimit. Projekti për shkrirjen e dyllit për bletë është në fazën e tenderimit, jemi në bashkëpunim me tri shoqata për marrëveshje të reja për bletarë, bashkëpunim me OJQ Islamic Relief, për mekanizim bujqësor: plugje, makina për mbjelljen e misrit, kosa rrotative, freza, multikultivatorë etj. Kërkesa për mbështetje me serra, bashkëpunimi me organizatën "The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints", e cila ka realizuar projektin e bunarëve nëpër institucione, kërkesa për mbështetje me sera edhe te dy shoqatat e tjera, për fermerët që janë të interesuar në zhvillimin e prodhimit të mbyllur.

1.5 Aktivitetet rinore në komunën e Kaçanikut;

Komiteti për Komunitete ishte i interesuar për kriteret e aplikimit të OJQ-ve dhe të shoqatave joqeveritare që përfitojnë mjete nga subvencionet, pasi ka nga to që janë në nivelin më të ulët të garave sportive, ndërkaq subvencionohen. Kur flasim për aspektin ligjor, nuk kuptojmë sesi një shoqatë e pensionistëve të përfitojë nga fondet e DKRS, ndërkaq nëse flasim për humanitet është diçka tjetër. Janë disa organizata që nuk e kanë të qartë bazën ligjore për subvencionim, ndërkaq janë përkrahur me subvencione

si ato të brendshme, ashtu edhe të jashtme. Më herët ka qenë edhe rasti i organizatës BONEVET. Ka pasur kërkesa nga shkollat e futbollit, të cilat kanë aplikuar dhe nuk janë subvencionuar përkundër plotësimit të kriterëve. Ka komuna të Kosovës që shkollat e futbollit subvencionohen rregullisht. Ka organizata që në aplikim deklarojnë të hyra të mëdha të jashtme edhe pse ato nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Kaçanik dhe përsëri përfitojnë. Ka nga to që kanë marrë fonde nga federatat, nga projekte të mëdha, apo donatorë të huaj, dhe përsëri janë subvencionuar nga komuna, ndërsa fëmijët nga familjet me kushte të vështira nuk mund të përballojnë as pagesën mujore për të marrë pjesë në aktivitete sportive dhe këta nuk subvencionohen fare. Nga Komiteti për Komunitete pati pyetje për çështjen e emërimit Palestrës sportive.

Për këto çështje folën zyrtarët e DKRS, Rini, Fatmir Çaka dhe Lumbardh Malsiu. DKRS e ka planin për vitin 2025, realizohet përmes aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive përmes thirrjeve publike. Thirrja e parë publike, 11.02.2025, janë formuar komisionet: Komisioni për verësimin e aplikacioneve të OJQ-ve, i përbërë nga 3 zyrtarë komunalë dhe 2 përfaqësues nga shoqëria civile. Përfaqësuesit nga shoqëria civile zgjedhen përmes një thirrje publike. Është i fortmuar edhe komisioni i ankesave. Në thirrjen e parë publike, kanë përfituar, 9 aplikantë, në fushën e kulturës, 3 shoqëri kulturo-artistike. Këto të fundit përfitojnë përmes subvencionimit të programeve të OJQ-ve, si dhe mbështetjes nga programet të drejtorisë. Shoqëritë kulturo-artistike, përveç aktiviteteve të tyre tradicionale (si "Java e Mërgimtarëve"), mbështeten edhe në pjesëmarrje në festivale të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Për këto aktivitete, është ndarë një buxhet prej 110,000€. Thirrja e dytë publike, më 14.04.2025, kanë përfituar 7 OJQ sportive dhe Shoqata e pensionistëve është në planin e DKRS- "Dita e të Moshuarve" (1 Tetori). Disa nga aktivitete që kanë nisur janë: Dita e Tokës, Dita e Librit, 1 Qershori -Dita ndërkombëtare e Fëmijëve, zhvillohen me pjesëmarrjen e OJQ-ve që kanë aplikuar. OJQ-të dhe ekipet sportive marrin pjesë në gara brenda Kosovës. Ne si drejtori, përmes komisionit të monitorimit, bashkëpunojmë ngushtë me të gjitha organizatat për të siguruar një organizim të suksesshëm dhe korrekt të aktiviteteve. Për subvencionet në sport, në thirrjen e parë janë shpenzuar 77.000€, në thirrjen e dytë 23,000€, gjithsej 100,000€, kanë mbetur 9.000€, për të cilat do të organizohet edhe një thirrje e tretë publike. Kriteret janë të përcaktuara, duhet të jetë i kompletuar dokumentacioni dhe OJQ duhet të jenë të regjistruara pranë Departamentit për OJQ. Kryesisht i përkrahim OJQ-të që zhvillojnë aktivitetet e tyre brenda komunës tonë dhe që i përshtaten plan-programit të drejtorisë. Baza ligjore është Rregullorja komunale dhe Rregullorja e ministrisë. Emërimit i Palestrës sportive, shkon bëhet me propozim të DKRS, miratohet nga kuvendi. Për kërkesat që nuk janë miratuar, komisioni ka dhënë përgjigje për refuzimin e tyre. Për pjesën e organizimit që e përmende të të rinjtë institucioni është përgjegjës t'i ndihmojë organizatat, por jo t'ua përcaktojë planin e aktiviteteve. Shumica e aplikimeve janë mbështetur, sipas asaj që kanë propozuar vetë. Ka pasur aktivitete për të rinj, si murale, aktivitetet e KVRL-së, Sporti shkollor. Të festivali, bëhet fjalë për të vetmin festival që ruan këngën popullore, dhe ata kanë bërë kërkesë edhe në ministri për ta mbrojtur si vlerë kulturore. Nuk ka pasur ndonjë OJQ që ka aplikuar me program për të rinj, dhe që nuk është mbështetur.

1.6 Gjendja e Bizneseve në komunën e Kaçanikut

Komiteti për Komunitete ishte i interesuar me ditur se a ka komuna rregullore për orarin e punës së bizneseve, distanca ndërmjet bizneseve me veprimtari të njëjtë, Shprehi shqetësimet për përfituesit e bizneseve start-up, janë pothuajse të njëjtët persona çdo vit. A ka kriter që ndalon përfitimin e përsëritur nga e njëjta familje ose subjekt? A merret parasysh gjendja familjare? Kush e formon komisionin për ndarjen e

subvencioneve, përbërja dhe a përfshihet ndonjë përfaqësues nga shoqëria civile? Bizneset që aplikojnë për subvencione, çështja e tregut të gjelbër për shitjen e produkteve të qumështit.

Për me dhënë sqarime të nevojshme në këtë temë, ishte Pranvera Loku Zharku-DZHET. Nuk ekziston ndonjë rregullore që përcakton distancën ndërmjet bizneseve me të njëjtën veprimtari. Në vitin 2024 janë ndarë subvencione, por kanë qenë vetëm për gratë në biznes, në vitin 2025 janë përfshirë edhe burrat. Kanë qenë gjithsej 18 përfitues, listat janë publike. Nëse aplikimet janë bërë me emra të ndryshëm brenda të njëjtës familje, kjo nuk është përgjegjësi e imja. Komisioni është ai që bën vlerësimin dhe ata janë thirrur për të verifikuar listat paraprake, dhe nuk kanë konstatuar ndonjë përsëritje të tillë. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, QKRB në Kaçanik ka kryer këto aktivitete: Regjistrimi i bizneseve të reja - 74, Shuarja e bizneseve - 05, Ndryshime në të dhënat e bizneseve -25, Ofrimi i informatave për bizneset - 59, Lëshimi i certifikatave dublikatë - 10. Të dhënat sipas formës së organizimit të bizneseve: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) -35, Biznese individuale (B.I.) - 39, Biznese me pronarë femra - 22, Biznese me pronarë meshkuj - 52. Pesë (5) aktivitetet më të shpeshta sipas kodeve të regjistruara: Punime për veshjen e dysHEMEVE - 11 biznese, Punime montimi nga druri dhe materiale të tjera - 8 biznese. Instalime të tjera ndërtimore -7 biznese, Aktivitetet të tjera të specializuara -7 biznese, Tregtia me shumicë -7 biznese. Statistikat e përgjithshme: Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuar në zyrën e ARBK- së, Kaçanik, për periudhën janar-qershor 2025 - 173. Biznese të hapura në periudhën janar-qershor 2024 - 77, ndërkaq janar-qershor 2025 -74. Diferenca: 3 biznese më pak. Komisioni formohet nga Kryetari i Komunës prej 3 anëtarëve, një zyrtar nga drejtoria përkatëse, tjetri nga DBF, i treti nga struktura gjinore. Janë ndarë rreth 51,000€, të cilat janë shpenzuar 50,500€. Kanë aplikuar gjithsej 44 biznese, përfitues kanë qenë 18, disa janë refuzuar në mungesë dokumentesh apo fondesh, disa nuk e kanë kaluar pragun prej 60 pikëve. Për pjesën e zhvillimit dhe shitjes së produkteve vendore merret DBPZHR.

1.7 Gjendja aktuale e QKMF;

Për gjendjen aktuale të QKMF, Komiteti për Komunitete ishte i interesuar për çështjen e furnizimit me barna esenciale në institucionet shëndetësore të komunës, dhe si qëndron situata lidhur me procesin e vaksinimit të qytetarëve? Pati kërkesë zyrtare për zgjatjen e orareve të punës në laborator, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje më të lehtë dhe shërbimi të bëhet më Kushtet higjienike aktuale në QKMF dhe a merren masa të rregullta për mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e hapësirave shëndetësore? Sa ka qenë fluksi i pacientëve gjatë kësaj periudhe dhe a ka funksionuar orari i barnatoreve sipas planifikimit? Këto dolën si kërkesa të Komitetit për Komunitete, meqë nuk ishte kush nga drejtoria për sqarime të nevojshme.

1.8 Rastet Sociale në Komunën e Kaçanikut;

Për këtë temë Komiteti për Komunitete ka debatuar në një mbledhje, ka ftuar zyrtarët përgjegjës për me marrë informacione lidhur me rastet sociale në komunën e Kaçanikut. Komiteti për Komunitete u interesua për numrin e personave me nevoja të veçanta? Si mbledhet komisioni mjekësor? Në krahasim me vitin paraprak, a është në rritje numri i fëmijëve me nevoja të veçanta apo ka rënie? Të adoptimi i fëmijëve, a ka pasur raste dhe cilat kritere duhet të plotësohen për adoptim të fëmijëve?

Pas adoptimit, a bëni vizita rasteve, në rast se fëmija ka nevojë për rehabilitim, se ka raste kur marrin vesh që janë të adoptuar, bëhen të dhunshëm dhe kanë probleme prindërit që e kanë adoptuar, edhe pse e dërgon fëmijën në psikolog privat. Ju si qendë, a ndërmerrni

diçka nëse pala drejtohet tek ju? Pas lajmërimit të rasteve të dhunës në familje, si trajtohen rastet, kush i mbikëqyrë? Sa i përket strehimit, në këto raste, ku përfundon ajo familje, nëse nuk do me shku në strehimore? Ju si qendër a ndërmerrni diçka? A është zvogëluar numri i familjeve me asistencë sociale apo është rritur?

Për me dhënë sqarime të nevojshme në këtë temë, ishte Antigona Axhami -Baftiu, zyrtare për shërbime sociale në QPS.

Prej muajit janar të këtij viti në Kaçanik, kemi 14 raste të dhunës në familje, 3 raste janë me urdhër mbrojtje, kemi pasur më shumë raste me urdhër mbrojtje por i kanë rregulluar marrëdhëniet dhe i është ndërprerë urdhër mbrojtja. Fëmijët me nevoja të veçanta që marrin ndihmë sociale 120€ në muaj, janë 67 raste, 5 raste kanë aplikuar që dalin në komision në muajin shtator. Të adoptimi, kemi pasur 9 raste, 3 raste janë hequr. Njëri rast jetojnë jashtë shtetit, ka aplikuar për adoptim vendor, por familjet që jetojnë jashtë shtetit duhet të aplikojnë për adoptim ndërkombëtarë. E kemi vizituar atë familje, e kemi parë që jetojnë jashtë shtetit dhe e kemi njoftuar gjykatën. Dy raste i ka hequr ministria, sepse nuk i plotësojnë kushtet. Me herët vlerësimin e kemi bërë ne, me ndryshimin e rregullores vlerësimin e bënë ministria. Ne i njoftojmë për rregullimin e dokumentacionit, jemi si ndërmjetës në mes të palës dhe ministrisë. Ka familje që janë tërhequr vet nga aplikimi. Aktualisht janë 5(pesë) familje që presin për adoptim, para dy muaj është adoptuar një fëmijë dhe është në procedurë të vlerësimit deri në adoptim përfundimtarë. Neve na intereson gjendja ekonomike dhe gjendja psikike e fëmijës së adoptuar. Janë të gjitha dokumentacionet e mjekut, psikologut etj., vizitojmë familjen a i plotëson kushtet për adoptim, e bëjmë vlerësimin. Pas adoptimit e vizitojmë deri në tre muaj dhe përcjellim nëse fëmija ka përkujdesje, e njoftojmë gjykatën. Pas tre muajsh familja e regjistron fëmijën në emër të vet. Ne si QPS merremi edhe rastet e viktimës dhe të dyshuarin. Nëse nuk ka ku të shkoj viktimë, e dërgojmë në strehimore derisa të bëhet një zgjidhje më afatgjatë, ka raste kur kanë përkrahje të dikush në familje, bisedojmë ndërkohë me ta dhe i këshillojmë, që sadopak të rregullohet raporti. Të rastet e bashkëshortëve ka raste që janë bashkuar, por edhe që janë ndarë. Nëse ka dhunë të vazhdueshme psikike dhe fizike unë nuk i këshilloj të bashkohen, por i udhëzoj të shkojnë në gjykatë, i njoftoj se si duhet të veprojnë rreth fëmijëve. Ne e kemi obligim me dërgu në strehimore deri në 6 muaj. Ka shumë raste që janë bashkuar, sepse strehimorja nuk i plotëson kushtet. Kam kërkuar që të banesa sociale të lihen të lira 2-3 banesa për këto raste, për zgjidhje përkohësisht, nuk ka pasur mundësi. Kemi pasur një rast në strehimore, ka qenë me fëmijë, ka kërkuar të kthehet te bashkëshorti se nuk mund të qëndronte në strehimore. Në bashkëpunim me gjykatën kanë mbajtur seancë dhe u kthye prap të dhunuesi se nuk kemi pasur zgjidhje tjetër për viktimen. Ne në QPS nuk mund të bëjmë gjithçka, shërbimi ynë është bashkëpunimi me gjykatën dhe policinë. Nuk e di numrin e saktë, mirëpo me sa di numri ka rënie të numrit të asistencës sociale.

Ekrem Livoreka- Kryesues i Komitetit: Për çështjen e banimit social, unë kam qenë pjesë e komisionit për ndarjen e banesave edhe unë kam menduar të lihen të lira 2 ose 3 banesa, por kanë qenë 67 aplikues për banesa dhe ne t'i lëmë banesat e zbrazëta nuk kishte mundësi, ndërkaj do të ishte mirë një banesë të bëhet vetëm për këto raste.

Për Komitetin për Komunitete
Kryesuesi, Ekrem Livoreka

